



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax: 04 232-491

Nr. 774/17 Prot.

Tiranë, më 31/12/2017

V E N D I M

Nr. 216, Datë 31/12/2017

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KUKËS ME OBJEKT "VLERËSIMI I PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË MBI SHKALLËN E ZBATIMIT NGA SUBJEKTI TË LIGJEVE RREGULLOREVE DHE POLITIKAVE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit me objekt: "*Vlerësimi i përputhshmërisë mbi shkallën e zbatimit nga subjekti të ligjeve rregulloreve dhe politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve*" të ushtruar në Bashkinë Kukës, për periudhën 01.01.2015 deri më 30.06.2017.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A-MASA ORGANIZATIVE

1-Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës është penalizuar nga gjykata për largime nga puna të punonjësve për zgjidhje të kontratës së punës në kundërshtim me nenet 144, 153, 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar dhe pikën 62 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si rrjedhojë e mosrespektimit të afatit të njoftimit e mosrespektimit të procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës, të mosvlerësimit të pasojave të padive që kanë ngritur punonjësit. Pavarësisht se shumica e çështjeve gjyqësore nuk kanë marrë formën e prerë, ato janë fituar nga paditësit në shkallën e parë të gjykimit si z.H.Y. me 9 paga mujore, z. Xh.M. me 9 paga mujore (Njësia Administrative Bicaj), zn.F.K. me 26 paga mujore dhe 65,000 lekë shpenzime gjyqësore, znj.B.C. për mbyllje e kontratës së punësimit me 8.5 muaj, L.A. me 4 paga mujore dhe leje

vjetore, F.K. me 26 paga mujore, L.B. me 26 paga mujore plus shpenzimet gjyqësore. (Trajtuar hollësisht në faqen nr.63-99 të Raportit të Auditimit).

1.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marr masa për ndjekjen e gjithë shkallëve të gjykimit për çështjet gjyqësore që nuk është marr vendimi formës së prerë, duke bërë një përgatitje serioze për mbrojtjen e tyre në gjykatë, njëkohësisht të analizohen me përgjegjësi shkaqet dhe të nxirret përgjegjësia për shkaktarët për moszbatimin e kërkesave ligjore për çdo rast largimi nga puna të punonjësve për zgjidhje të kontratës së punës, në kundërshtim me nenin 144; 153; 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe pika 62 e UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde”.

Menjëherë.

2-Gjetje nga auditimi: Rezulton mungesa e listës së saktë të debitorëve, gjë e cila ndikon mbi besueshmërinë e informacionit financiar të raportuar në lidhje me llogaritë e arkëtueshme. Bashkia Kukës të ri analizoje për çdo Njësi Administrative gjendjen e debitorëve në llogaritë e tyre për të cilat nuk gjenden të dhëna të sakta. Ekziston nivel i lartë i pasigurisë në lidhje me faktin nëse vlerat për tu arkëtuar nga debitorët do të mund të mbledhen. Në njësinë administrative Bicaçaj, ku ndodhet shkolla 9/vjeçare Kolesian ka punuar ish/drejtor V.B, sipas procesverbalit nr.16, datë 12.06.2016 kanë rezultuar mungesa inventari ekonomik llog.218 (pajisje kompjuterike, 1 njësi qendrore kompjuteri, 1 kompjuterë komplet, 1 UPS630, 1 printer, 1 skaner model 25 dhe 1 pajisje kompjuterike) në shkollën 9/vjeçare Kolesian në shumën **145,115 lekë**. Po në këtë njësi në shkollën 9/vjeçare Gabric janë konstatuar mungesa në shumën **66,000 lekë** llog.218 (pajisje kompjuterike 1 copë Kompjuter komplet, 1 cope laptop, 1 copë tastier, printer, 1 copë toner vaisje kompjuterike të cilat nuk janë analizuar, nuk është llogaritur amortizimi dhe nuk është nxjerrë përgjegjësia personale. (Trajtuar hollësisht në faqen nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

Menjëherë.

2.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës, Drejtoria ekonomike dhe Drejtoria juridike të rikrijojnë regjistrin e plotë të debitorëve me të dhëna të sakta në mënyrë që të mundësohet mbledhja e të arkëtohen detyrimet. Këto regjistra duhet të kenë si minimum detaje mbi identifikimin e kredencialeve të debitorëve, vlerën e arkëtueshme, të dhënat mbi vjetërsinë, pritshmërinë nëse shumat janë të mbledhshme. Të analizohen rezultatet e mungesave të inventarëve ekonomik të kryer, të përcaktohet përgjegjësia ligjore e të dilet me vendim përfundimtar për mungesat e ndryshme për mosdorëzim të materialeve nga ish/Drejtorë e shkollës V.B.

Menjëherë.

3-Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat në pasqyrën financiare, konstatohet se gjendja e debitorëve në bashkia Kukës është në vlerën **53,079,770 lekë**, të evidentuara përkatësisht në llogarinë 468 “Debitor të ndryshme Bashkia Kukës, nuk ka marr masa të nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë në mospërputhje me kërkesat ligjore. (Trajtuar hollësisht në faqen nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

3.1-Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike në Bashkia Kukës, të marr masa të analizojë debitorët dhe të ndërmarr iniciativat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë me qëllim për të rritur aftësinë pagesë të rrisë burimet financiare të saj.

Menjëherë.

4-Gjetje nga auditimi: Nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, në kundërshtim me Kapitulli III, pika 30 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Bashkia të marr masa për plotësimin e regjistrit të pronave sipas UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre “, pika 26. (Trajtuar hollësisht në faqen nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

4.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës, në të cilën përfshihen 14 Njësi Administrative të marr masa, që Drejtoria e Financës të plotësojë definitivisht regjistrin e aktiveve në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër, si dhe grupit përkatës brenda llojit, ku të përfshijnë këto të

dhëna: datën e hyrjes, ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëvonshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, deri në daljen tij jashtë përdorimit, domosdoshmëri kjo për të patur evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit.

Menjëherë.

5-Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nëpërmjet bilanceve të dorëzuara më datë 30.06.2015, datë 31.12.2015, datë 31.12.2016 rezultojnë se:

-Gjendja e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa” në datën 31.12.2016 paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën 21,436,040 lekë nga vlera prej 20,433,447 lekë gjendje në datën 31.12.2015 në rritje vlera 1,002,593 lekë. Gjendja e kësaj llogarie rezultojnë e trashëguar nga periudha raportuese 2014 dhe 2015 detyrime të ndalura nga financat të pa derdhura.

Shqetësuese paraqitet gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” në datë 31.12.2016 paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën 46.689,439 lekë, nga vlera prej 47,119,552 lekë e rezultuar në datë 31.12.2015 në ulje vlera 430,113 lekë. Megjithatë shihet se gjendja e kësaj llogarie është me ulje, përsëri bashkia Kukës ka detyrime në kontabilitet të pa derdhur në DRT Kukës, për sigurimet shoqërore. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.63-99 të Raportit të Auditimit).

5.1-Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për gjetjen e burimeve financiare për të derdhur detyrimet e mësipërme në destinacionin e duhur, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, Drejtorinë përkatëse.

Menjëherë.

6-Gjetja nga auditimi: Janë mbajtur procesverbale dhe janë nxjerrë vendime për prishje të objekteve, ndërsa nuk janë ekzekutuar dhe nuk janë shoqëruar me gjobë për 8 subjekte edhe pse janë konstatuar shkelje ligjore, konkretisht në subjektet: z.D.H. për “Rrethim me zgarë”, z.D.D. për “Rrethim me zgara dhe shkalle”, z.R.Z. për “Rrethim muri, platform”, z.K.S. për “Mur guri xokël”, z.I.M. për “Mur me blloqe”, z.A.S. për “Mur rrethues”, znj.L.U. për “Gardh teli”, z.L.B. për “Rrjet Teli”, veprime në mospërputhje me pika 8, germa (a), neni 82 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar me ligjin nr .110/2013 dhe ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin e Zhvillimit Urban”, neni 52, pika 1, germa “e”. (Trajtuar hollësisht në faqen nr.279-292 të Raportit të Auditimit).

6.1-Rekomandimi: Të merren masa nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) që në bashkëpunim me Zyrën e Urbanistikës të evidentojë ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoba ndaj subjektet ndërtuese të kundraligjshme me qëllim mbajtjen nën kontroll, administrimin dhe zhvillimin e territorit.

Menjëherë.

7-Gjetja nga auditimi: Nga IVMT janë nxjerrë 19 vendime administrative me gjobë në vlerën e mbetur 4,150,000 lekë e cila nuk është arkëtuar, duke mos marr masa të nevojshme për ndjekjen e këtyre çështjeve në rrugë gjyqësore, veprime në mospërputhje me neni 16 ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve” i ndryshuar dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nuk është arkëtuar asnjë vlerë, si dhe nuk është bërë kontabilizimi tyre, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kapitulli I “Mbajtja e kontabilitetit”, pika 2, germa (c) “Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”. (Trajtuar hollësisht në faqen nr. 279-292 të Raportit të Auditimit).

7.1-Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 4,150,000 lekë, të krijuar nga gjobat e vendosura nga Inspektorati.

Menjëherë.

8-Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria të Ardhurave të Bashkisë Kukës, nuk janë krijuar dhe mbajtur regjistrat përkatës për të administruar dhe evidentuar të dhënat e nevojshme për numrin e plotë e të saktë të subjekteve të biznesit, të familjeve, të banesave, të ndërtesave dhe sipërfaqen e tokës bujqësore, me qëllim që përllogaritja e të ardhurave vendore që duhet të krijohen nga aplikimi nivelit të tarifave e taksave të miratuara me paketën fiskale, të jenë sa më afër realitetit veçanërisht për taksën e pasurisë së paluajtshme që i përket (*banesave, ndërtesave dhe tokës bujqësore*) veçanërisht në Njësitë Administrative (*ish/Komunat*) edhe nëpërmjet bashkëpunimit me ZVRPP Kukës për të dhënat e pronësisë mbi tokën bujqësore, banesat dhe ndërtesat.

-Si pasojë e mungesës së regjistrave përkatës dhe mos evidentimi e mos pasqyrimi i plotë i subjekteve (*familjar, biznese, pasuri e paluajtshme banesa, ndërtesa e tokë bujqësore*), si dhe mos administrim i saktë i të dhënave ka sjell për vitin 2015 dhe 2016 të ardhura të munguara për buxhetin e njësisë shpenzuese në vlerën **26,301 mijë lekë**. (*Trajtuar hollësisht në faqen nr.279-292 të Raportit të Auditimit*).

8.1-Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të marr masat për të përfunduar hapjen e regjistrave (*manuale, excel, apo elektronik*), për të evidentuar numrin e subjekteve të biznesit, familjeve, sipërfaqen e taksës bujqësore, pasurinë e paluajtshme (*ndërtesa e banesa*) numrin e mjeteve të transportit në juridiksion të bashkisë Kukës, duke ndjekur të gjitha shkallët e bashkëpunimit me institucionet përkatëse, me qëllim që programimi, administrimi dhe përllogaritja e të ardhurave nga zbatimi i nivelit të tarifave e taksave vendore të miratuara me VKB në paketa fiskale të jetë sa më e saktë dhe më afër realitetit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

9-Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e nivelit të tarifave e taksave të miratuara pas përllogaritjes së detyrimit u konstatua se, DTTV për detyrimet e lindura për pagesë nga subjektet (*familjar apo biznesi*), nga zbatimi i nivelit të taksave e tarifave vendore në njoftimin e detyrimit nuk ka evidentuar me analizë çdo detyrim të lindur në periudhën përkatëse, për të cilën u bë rivlerësim dhe njoftim detyrimi për periudhën 2015 dhe 2016, njëkohësisht shpërndarja e “*Njoftim detyrimi*” është dërguar vetëm në subjekte biznesi, ndërsa nuk është dërguar për subjektet familjar në juridiksion të njësisë administrative bashkia Kukës me detyrimet e lindura, ndërsa njoftimi detyrimit nuk është drejtuar edhe në zyrën financës me qëllim që çdo detyrim të kontabilizohet. (*Trajtuar në faqe nr. 264-279 të Raportit të Auditimit*).

9.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për detyrimet e lindura për pagesës të pasqyruara në “*Njoftim detyrimi*” një kopje detyrimisht të drejtohet në zyrën financës me qëllim që detyrimi i lindur të kontabilizohet dhe shumat e detyrimit nëpërmjet kontabilizimit të administrohet në kontabilitet me analizë dhe me përfundimin e afatit të pagesës çdo detyrim të pa likuiduar të administrohet nga menaxhimi borxhit, për të cilën të përllogariten kamatëvonesat përkatës e të aplikohen penalitetet, veprim i pa realizuar deri në këtë moment.

Menjëherë.

10-Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e pasqyrave financiare konstatohet se, gjendja e debitorëve është në vlerën **53,079,770 lekë** evidentuar në llogaria 468 “*Debitor të ndryshme*”, ndërsa Bashkia Kukës nuk ka marr masat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë në mospërputhje me kërkesat ligjore. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr.63-99 të Raportit të Auditimit*).

10.1-Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike në Bashkinë Kukës, të marrë masa, të analizojë debitorët dhe të ndërmarr iniciativat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga debitorët, me qëllim rritjen aftësinë pagese e të rrisë burimet financiare të saj.

Në vazhdimësi.

11-Gjetje nga auditimi: Sipas Bilancit gjendja e llog.40-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” në fund të vitit 2015 paraqitet në shumën 41,038,077 lekë detyrime të papaguara për blerje e investime. Ndërsa sipas detyrimeve të konstatuara për fatura te papaguara për blerje

dhe investime janë në shumën 166,411,187 lekë. Pra nuk janë përfshirë në kontabilitet vlera prej 125,373,110 lekë, shumë e cila përbëhet nga detyrime të pa kontabilizuara që nga vitet para 2015 dhe gjatë vitit 2015 në mospërputhje me UMF nr. 14, datë 28.12.2006 dhe nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen e pasqyrave financiare”, Plani Kontabël Publik, klasifikimi buxhetor dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 52, 54, 60 me UMF nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar pika 144, 146. Gjendja e detyrimeve në datë 31.06.2017 është shuma **101,571,547 lekë** e cila përfshin detyrimet ndaj të tretëve (llog.602) për fatura blerje mallra e shërbime në shumën 6,277,234 lekë, detyrime ndaj ndaj Tatim Taksave për sigurime shoqërore dhe TAP shuma 65,202,986 lekë, detyrime ndaj të tretëve për investime (llog.230-231) shuma 26,290,204 lekë dhe detyrime ndaj të tretëve për “Vendime Gjyqësore” shuma 3,802,123lekë. (Trajtuar hollësisht në faqen nr.63-99 të Raportit të Auditimit).

11.1-Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marr masa të kontabilizojë detyrimet e konstatuara të papaguara të Bashkisë Kukës ndaj të tretëve e Tatim Taksave mbi bazën e kontributeve të pa derdhura për sigurimet dhe tatimin mbi pagë në vite për punonjësit, për detyrimet ndaj të tretëve mbi bazën e faturave të blerjeve për mallra e shërbime dhe situacioneve të faturuara të mbështetura në kontratat e sipërmarrjeve për investime. Të sigurojë marrëveshje me Degën e Thesarit për pagesën me këste të detyrimeve për sigurime shoqërore e tatime dhe vendimeve gjyqësore periodikisht sipas aftësisë paguese të bashkisë.

Menjëherë.

12-Gjetje nga auditimi: Sipas ditarit të bankës rezulton se, me urdhër-shpenzim nr. 191, datë 07.07.2015 është kryer pagesa në shumën **3,431,443 lekë** për OE “K...”shpk fitues i tenderit të ushqimeve. Ky urdhër shpenzim mungon bashkë me praktikën e bashkëlidhur si fatura, fletë-hyrje në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24, 10, 11, 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 35, 36, 37, 52, 53, 54. (Trajtuar hollësisht në faqen nr.63-99 të Raportit të Auditimit).

12.1-Rekomandimi: Drejtoria e Buxhetit dhe Financës të marrë masa për sigurimin dhe plotësimin e dokumentacionit të plotë financiar të praktikës së kësaj pagesë në rast të mosrakordimit me hyrjet me magazinën të ngarkohet me detyrim për pagesë ish-Drejtori Ekonomik për këtë shumë.

Menjëherë.

13-Gjetje nga auditimi: Me urdhër/shpenzim nr. 880, datë 23.12.2016 është bërë pagesë në shumën 947,880 lekë OE fitues i procedurës së prokurimit me vlera të vogla “O...”shpk në bazë të Urdhër-prokurimit nr. 528 datë 20.10.2016 me objekt: “Për blerjen e një autoveture marka “Wolkswagen” tip “Sharan” për Policinë bashkisë, faturës nr. 257 datë 21.12.2016 dhe fletë-hyrjes nr. 249, datë 23.12.2016. Në procedurën e prokurimit u paraqitën këto mangësi: Procedura e prokurimit ka dështuar dy herë për mosparaqitje të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, të cilët kanë qenë relativisht të shumtë, procesverbalet e njoftimeve të kualifikimit të operatorëve të radhës nuk janë shoqëruar me shkarkimet nga sistemi elektronik i APP i mesazheve të korrespondencës me këta operatorë për të vërtetuar njoftimet dhe përgjigjet e tyre; procedura është zhvilluar në mënyrë manuale sipas procesverbalit të tregut të mbajtur nga KPVV në datë 16.12.2016 dhe raportit të procedurës në datë 19.12.2016 është shpallur fitues OE “O...”shpk. (Kontrata e shitblerjes ndërmjet OE “O...”shpk dhe Bashkisë Kukës është lidhur në datën 19.12.2016, ndërsa OE “O...”shpk ka blerë mjetin nga Sh.P. nëpërmjet kontratës së shitblerjes në datën 20.12.2016, pra një ditë pas kontratës së shitjes së mjetit nga OE “O...”shpk Bashkisë Kukës). Këto veprime e bëjnë të parregullt këtë procedurë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26. (Trajtuar hollësisht në faqen nr.63-99 të Raportit të Auditimit).

13.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa që prokurimi i fondeve për blerje mallra e shërbime të bëhet në mënyrë eficiente, konform dispozitave ligjore dhe të mos shmangë konkurrencën. Të mos përsëriten rastet e procedurave fiktive të prokurimit.

Menjëherë.

14-Gjetje nga auditimi: Për Bashkinë Kukës dhe ish/Komunën Surroj është bërë miratimi me VKM e transferimit të listës përfundimtare të pronave, ndërsa për 13 ish/Komunat e tjera transferimi i pronave është në fazën e miratimit me VKM të listës paraprake të pronave. Nga Bashkia nuk është ndërmarrë asnjë hap për ndjekjen e miratimit të transferimit të listave përfundimtare të pronave të ish/Komunave, sot të NJA përkatëse në pronësi të Bashkisë Kukës në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar dhe me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” neni 8, 32. *(Trajtuar hollësisht në faqe nr. 292-299 të Raportit të Auditimit).*

14.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të ndiqen procedurat për transferimin e listave përfundimtare të pronave të ish/Komunave në pronësi të Bashkisë dhe vendosjes së korrespondencës zyrtare me institucionet përkatëse për përfundimin e procesit të miratimit me VKM. Gjithashtu për pronat sipas listave të hartohet një program i miratuar nga Titullari për ngritjen e grupeve të punës, të kryerjes së inventarizimeve fizike që në momentin e transferimit e në vazhdim dhe verifikimin në terren të ndryshimeve nga përcaktimet e listës për të bërë dhe azhurnimet përkatëse në rast mospërputhjes si dhe dokumentimin e rasteve të zënies forcërisht në mënyrë të paligjshme të sipërfaqeve të trojeve e objekteve, parcelave nga fondi pyjor e kullësor pronë e bashkisë dhe ndjekjen e procedurave ligjore për to.

Menjëherë.

15-Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Kukës nuk janë ndjekur procedurat për verifikimin dhe përcaktimin e sipërfaqeve të rrugëve që shfrytëzojnë 30 subjektet e pajisura me lejë minerare nga karriera apo shesh depozitimet në rrugët nacionale në fondin pyjor-kullësor pronë e Bashkisë dhe lidhjen e kontratave të qiradhënies me to, ose taksimin e zënies së këtyre hapsirave. Po kështu për 8 Shoqëritë koncensionare të HEC^{ve} që ushtrojnë aktivitetet në parcelat e fondit pyjor kullësor pronë e Bashkisë, nuk është bërë identifikimi i sipërfaqeve që zënë ngrehinat dhe tubacionet, duke mos bërë lidhjen e kontratave të qiradhënies apo taksimi i zënies së hapësirës të këtyre subjekteve për sipërfaqet që shfrytëzojnë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nenet 23, pika 7, dhe 26, pika 10 të ligjit nr. 9385, date 04.05.2005 “Për pyjet e shërbimin pyjor”, me VKM nr. 22, date 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal” pika 6, me UMB nr.4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullësor publik, me VKB te vitit 2016 dhe 2017 “Për taksat dhe Tarifat vendore”, të cilat kanë sjellë pasojë të ardhura të munguara për Bashkinë për periudhat 2016-2017. *(Trajtuar hollësisht në faqe nr.292-299 të Raportit të Auditimit).*

15.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës nëpërmjet Drejtorisë së Pyjeve, Drejtorisë Taksave dhe Drejtorisë Juridike të ngrihen grupet e punës të miratuara nga Titullari i njësisë vendore për grumbullimin e dokumentacionit, verifikimin dhe përcaktimin e sipërfaqeve të rrugëve të kalimit nga vend depozitimet minerale në rrugët kryesore për 30 subjektet e pajisura me lejë minerare, identifikimi sipërfaqeve që zënë ngrehinat e tubacionet 8 shoqërive koncensionare të HEC^{ve} për taksimin apo lidhjen e kontratave për qiradhënie për shfrytëzimin e këtyre sipërfaqeve të fondit pyjor/kullësor pronë e bashkisë me qëllim rritjen e të ardhurave.

Menjëherë.

16-Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në arkivin e institucionit i dokumentacionit të vendimeve të miratuara në Këshillin e Bashkisë Kukës, për periudhën objekt auditimi rezultoi se për 6/mujori parë viti 2015 janë marrë 39 vendime nga këshilli bashkiak për tjetërsim e parcelave ndërtimore, trojeve prona të Bashkisë Kukës si dhe privatizim falas të apartamenteve që shfrytëzohen nga banorë të Kukësit. Shitja e këtyre pronave do të bëhej kundërshtim të tregut, proces ky që i ngarkohej Drejtorisë Juridike. Nga këto VKB janë materializuar 9 procedura për të cilat janë përgatitur dosjet tekniko-ligjor, janë kryer pagesat dhe janë lidhur kontratat. Në rastet e tjetërsimit të parcelave ndërtimore dhe trojeve nuk janë

përcaktuar nëse janë sheshe apo troje, ku janë bërë ndërtime ose janë dhëne leje ndërtimi, kategori këto që klasifikohen të tjetërsueshme, çka bën marrjen e VKB për këto raste si dhe rastet e ekzekutimit të tyre veprime në mospërputhje me ligjin nr. 7980 datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve” me ndryshime, neni 1 dhe 4. Ndërsa në VKB për dhënie pa pagesë të apartamenteve në 4 raste nuk përcaktohet për çfarë arsye, kjo banesë privatizohet pa pagesë në kundërshtim me nr. 7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” me ndryshime neni 7 i cili përcakton kategoritë e banorëve që përfitojnë falas privatizimin e banesës dhe dokumentacioni shoqërues për klasifikimin në një nga kategoritë e e miratuar me këtë ligj. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 292-299 të Raportit të Auditimit).

16.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për rishikimin dhe anulimin e VKB të marra dhe të pa ekzekutuara për tjetërsimin e trojeve dhe parcelave ndërtimore, si dhe privatizimin falas të banesave, ku për këto të fundit të përcaktohen kategoria e personave që e përfitojnë banesën falas nëse janë pjesë e klasifikimit të përcaktuar në ligj.

Menjëherë.

17-Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave, u konstatua se:

-Për 6 raste, AK nuk ka vërtetuar, argumentuar dhe dokumentuar lidhur me përdorimin e procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, e për pasojë këto procedura nuk duheshin zhvilluar me negociim, por duhet të zhvilloheshin procedura sipas parashikimeve të LPP. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 33 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 36. Në të gjitha këto raste, AK është shmangur nga dispozitat e prokurimit publik, pasi ka zhvilluar procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të cilat janë procedura që nuk zhvillohen me mjete elektronike, si dhe nuk publikohen në sistemin e prokurimit elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik. Në të gjitha rastet e audituara, AK nuk argumenton përdorimin e procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, e cila është një procedurë që përdoret vetëm në rrethana të caktuara, të dokumentuara dhe të argumentuara ligjërisht. Në asnjë prej rasteve të audituara, titullari AK nuk ka nxjerrë Urdhër Prokurimi, për pasojë nuk ka ngritur njësinë e prokurimit dhe komisionin e vlerësimit të ofertave. Bazat ligjore të dhëna nga AK për përdorimin e kësaj procedure, janë të gabuara, në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik. Në asnjë rast, AK nuk justifikon përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, si dhe në asnjë rast nuk është dokumentuar publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar. Në të gjitha rastet e audituara, AK nuk ka mbajtur asnjë dokumentacion tenderi, mbi përdorimin e kësaj procedure, sikurse parashikohet në ligj. AK ka lidhur kontrata shtesë me operatorë ekonomikë, të cilët nuk kanë marrë përsipër të realizojnë këto lloj zërash punimesh, sipas kontratës së bashkëpunimit, për të cilën janë shpallur fitues sipas kontratës fillestare. Në të gjitha rastet e audituara, kontratat shtesë janë lidhur në kundërshtim të plotë me legjislacionin e prokurimit publik.

- Nuk janë kryer trajnime të stafit për prokurimin publik, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 83, pika 2.

- Në të gjitha rastet AK nuk argumenton e dokumenton, lidhur me hartimin dhe përlllogaritjen e vlerës së fondit limit, sikurse parashikohet në VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit” i ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”, si dhe nenin 28 të LPP.

- Në të gjitha rastet, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk kanë plotësuar deklaratat që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit me operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në kundërshtim kjo me pikën 2 të nenit 64 të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”.

-Në 10 raste, AK ka kualifikuar operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim, në kundërshtim kjo me nenin 53/3 të LPP. Gjithashtu, AK ka vepruar në kundërshtim të plotë me neni 56 të LPP, lidhur me skualifikimin e ofertave anomalish të ulta.

-Në 10 raste, autoriteti kontraktor ka mbajtur dy qëndrime, lidhur me vlerësimin e ofertave të paraqitura, duke skualifikuar të gjitha ato oferta të cilat janë me vlerë më të ulët të paraqitur, si dhe duke kualifikuar vetëm ato oferta, të cilët janë pothuajse afër vlerës së fondit limit, pavarësisht se kanë edhe të njëjtat mangësi. Pra, i njëjti kriter për kualifikim, për ofertat më të ulta të paraqitura konsiderohet si kusht për skualifikim, ndërkohë që për ofertën me vlerë më të lartë, me të cilin nënshkruhet edhe kontrata, nuk konsiderohet si kusht skualifikues.

-Në 10 raste, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 24/1 të LPP, si dhe nenin 73 të VKM së mësipërme, pasi në të gjitha këto raste, AK duhej të kishte bërë anulimin e procedurës së prokurimit, në kushtet kur në garë nuk ngelej asnjë ofertë e vlefshme. Në kundërshtim me këto dispozita, AK ka kualifikuar shoqëri të cilat nuk plotësojnë kërkesat për kualifikim.

-Në 10 raste, titullari i Bashkisë Kukës ka miratuar raporte përmbledhëse, në kundërshtim të plotë me nenin 68 të VKM së mësipërme.

-Në 6 raste, të përdorimit të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, AK nuk ka mbajtur raportin përmbledhës, ku përgjegjësia bie mbi titullarin e Bashkisë Kukës, pasi ka shkëlur nenin 68 të VKM së sipërcituar.

-Në të gjitha rastet, nuk është kryer ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit, në mënyrë që të përcaktohet përgjegjësia individuale e tyre.

-Në 6 raste të përdorimit të procedurës me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, nuk është mbajtur asnjë dokumentacion, si dhe nuk është bërë negociim lidhur me ofertën e dhënë, në kundërshtim të plotë kjo me legjislacionin e prokurimit publik, ku përgjegjësia bie mbi titullarin e AK.

-Në 6 raste, titullari i AK nuk ka nxjerrë urdhrin e prokurimit, në kundërshtim kjo me nenin 56 të VKM së mësipërme.

-AK nuk ka bërë asnjë verifikim, lidhur me sa është trajtuar hollësisht më sipër, për të cilin, bazuar në nenin 12/1 të LPP, përgjegjësia bie mbi autoritetin kontraktor. *(Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit).*

17.1-Rekomandimi: Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

-Autoriteti Kontraktor në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike;

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare, si dhe sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Nga Titullari Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës ti kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të miratimit të raportit përmbledhës, ku pasqyrohet shqyrtimi dhe vlerësimi nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste vlerësimi ofertave konstatohet jo korrekt;

-Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe të miratohen nga titullari i Autoritetit Kontraktor;

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Nga titullari Autoritetit Kontraktor, të merren masa lidhur me zhvillimin e procedurave me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të cilat duhet të përdoren vetëm në rrethana të veçanta dhe të argumentuara ligjërisht, sikurse parashikohet në legjislacionin e prokurimit publik.

-Titullari i Autoritetit Kontraktor, të marrë masa që në kontratat shitesë, zërat e punimeve të jenë të miratuara nga projektuesi dhe të argumentuara teknikisht, si dhe për punimet e domosdoshme por të palidhura teknikisht me kontratën bazë, të zhvillojë procedura prokurimi sipas legjislacionit të prokurimit.

-Në të gjitha rastet e prokurimit publik, AK duhet të argumentojë dhe dokumentojë, lidhur me përlogaritjen e vlerës së fondit limit.

-Në të gjitha rastet, AK duhet të vlerësojë me objektivitet ofertat, duke vepruar në përputhje të plotë me nenin 53/3 të LPP.

-Në të gjitha rastet, AK duhet të veprojë sipas parashikimeve të nenit 56 të LPP. Lidhur me ofertat anomalish të ulta.

-Në të gjitha rastet, AK nuk duhet të mbajë asnjëherë dy standarde në vlerësimin e ofertave pjesëmarrëse, si dhe duhet të vlerësojë konform parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-AK duhet të bëjë të gjitha verifikimet përkatëse, për sa është trajtuar hollësisht më sipër, si dhe në varësi të rezultateve të verifikimit, të veprojë konform dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

-Komisioni i vlerësimit të ofertave, në çdo procedurë prokurimi, duhet të plotësojë edhe deklaratat mbi konfliktin e interesit, me operatorët ekonomikë pjesëmarrës, deklarata të cilat gjenden në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Vazhdimisht.

18-Gjetje nga auditimi: Në 7 investimet e audituara në Bashkinë Kukës, me vlerë totale të kontratave **49,79,236 lekë me tvsh** nga verifikimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **15,582,564 lekë pa tvsh**, mos aplikim i penaliteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve në vlerën **654,765 lekë** si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pika 9 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit).

18.1-Rekomandim:Nga Bashkia Kukës, të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, pika, 4 paragrafi 4.

Menjëherë.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet e konstatuar me shkelje në pagesat e kryera dhe të likuiduara të trajtuara në Raportin e Auditimit, nga njësia administrative bashkia Kukës të merren masa të menjëhershme, për të kryer kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin dhe shpërblimin **e dëmit në buxhetin e bashkisë në shumën 59,090,641 lekë** që përfshin pagesat e paligjshme, procedurat e prokurimit dhe zbatimin e punimeve të ndërtimit, në mënyrë analitike sa më poshtë:

1-Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës me projekt strukturën e miratuar nga Kryetari e kthyer në vendim nga Këshilli Bashkiak, në 8 raste ka kryer pagesa të paligjshme për punonjësit në

shumën **606,323 lekë**, ndërkohë që vendi i punës kërkon punonjës me diplomë të integruar DIND, DND ose Master Shkencor; ku janë vendosur punonjës me diplomë Bachelor e barazvlefshme me DNP, veprime në mospërputhje me pika 12, paragrafi V, lidhjet 2 e 7, të VKM nr.1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të njësive të qeverisjes vendore” i ndryshuar, me VKM nr.518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr.586, datë 17.07.2013 i ndryshuar me VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.63-99 të Raportit të Auditimit).

1.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **606,323 lekë** për pagesa të paligjshme nga 8 punonjësit si me poshtë:

- 1-M.S. në vlerë 27,819 lekë.
- 2- A.Sh. në vlerë 84,876 lekë.
- 3-V.G. në vlerë 47,275 lekë.
- 4-P.E. në vlerë 55,713 lekë.
- 5-K.K. në vlerë 199,148 lekë.
- 6-H.B. në vlerë 177,372 lekë.
- 7-H.H. në vlerë 11,600 lekë (bonus).
- 8-L.Gj. në vlerë 2,520 lekë (pa dokumente).

Menjëherë.

2-Gjetje nga auditimi: Në mospërputhje me shkronja (dh), (ë) të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe nenit 35/b 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, janë të pa argumentuara me dokumente konsumi për 926 litra naftë nga dy autoveturat të administratës së Bashkisë me efekt financiar negative në dëm të buxhetit të bashkisë në vlerën **132,404 lekë**. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

2.1-Rekomandim: Nga bashkia Kukës të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **132,404 lekë** nga 4 punonjësit si me poshtë:

- 1-E.H. në vlerë 40,132 lekë.
- 2-R.Sh. në vlerë 3,318 lekë.
- 3-B.D. në vlerë 44,477 lekë.
- 4-M.C. në vlerë 44,477 lekë.

Menjëherë.

3-Gjetje nga auditimi: Me urdhër-shpenzimin nr. 148/1, datë 15.06.2015 është bërë pagesë në shumën **360,000 lekë** OE “F...”shpk për shpenzime transporti për administratën e Bashkisë Kukës në bazë të urdhër prokurimit nr. 47, datë 18.12.2014 dhe faturës nr. 05, datë 31.12.2014. Objekti i prokurimit nuk është i plotë, pasi nuk përcaktohet destinacioni i udhëtimit dhe nuk ka program se për çfarë është kryer ky udhëtim. Nuk ka argumentim të nevojës së blerjes së këtij shërbimi dhe të fondit limit. Fatura nuk përcakton çmimin për njësi. Udhëtimi turistik për administratën e bashkisë nuk është pjesë e funksioneve të njësive vendore. Veprime në mospërputhje me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” në zbatim të ligjit organik të buxhetit, Kreu II, pika (3) “Buxheti vendor” i ndryshuar pika (113), me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24, 10, 11. 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika (35), (36) me pasojë **dëmi ekonomik në shumën 360,000 lekë**. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

3.1-Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **360,000 lekë** nga KPVV në mënyrë solidare sa më poshtë:

- 1-L.D. ish-Drejtor Ekonomik në shumën 120,000 lekë.
- 2-F.T. ish-Drejtor i Shërbimeve në shumën 120,000 lekë.
- 3-B.B. ish-Drejtor Juridik në shumën 120,000 lekë.

Menjëherë.

4-Gjetje nga auditimi: Me urdhër/shpenzimi nr. 720, datë 13.10.2016 është kryer pagesa në shumën 5,000,000 lekë për transferim fondi i Qendrës së Studimeve Arkeologjike për financimin e projektit shkencor “Kalaja e Pecës-Kukës, rivlerësim i gërmimeve të viteve 1985-1989 dhe krijimi i hartës së zonifikimit arkeologjik”. Për realizimin e këtij projekti nga Bashkia është lidhur kontrata nr. 668, datë 25.09 2016 me afat 9 mujor, ndërsa nuk është përcaktuar vlera e kontratës, përveç vlerës prej 5,000,000 lekë e cila duhet të derdhej menjëherë pas lidhjes së kontratës. Për këtë vlerë nga Qendra e Studimeve Arkeologjike është hartuar preventivi i projektit, ku ndër zërat e tjerë ka përcaktuar 20% të vlerës për “punime të paparashikuara”, zë i situacionit për të cilën nuk ka analiza dhe argumentim, veprim në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7 dhe 12 me pasojë **dëmi ekonomik në shumën 715,000 lekë.** (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

4.1-Rekomandim: Nga bashkia Kukës të marren masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **prej 715,000 lekë**, nga Qendra e Studimeve Arkeologjike përfituar tepër për punime të pakryera.

Menjëherë.

-NË PROKURIMIN E FONDEVE PUBLIKE.

Nisur nga gjetjet e konstatuara me shkelje në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe në zbatimin e kontratave në punimet e ndërtimit të trajtuara në Raporti Auditimit, nga njësia administrative bashkia Kukës, të merren masat e menjëhershme për të kryer kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin dhe shpërblimin në mënyrë analitike sa më poshtë:

5-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural, Bashkia Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës është **1,922,606 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit).

5.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **1,922,606 lekë**, nga B.Sh., I.K., E.L. dhe A.V.

Menjëherë.

6-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Rikonstruksion i Qendrës Sociale, Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës është **4,100,826 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3, 56 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

6.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **4,100,826 lekë**, nga B.Sh, A.V, H.M, E.L.

Menjëherë.

7-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Kukës, është **398,400 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

7.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **398,400 lekë**, nga B.Sh, A.V, E.L, A. E.

Menjëherë.

8-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Rikonstruksion i rrugës M. Mamëz-vend depozitimi mbetjeve + ndërtimi rrethimit të jashtëm*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **2,220,480 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me neni 53/3, 56 të

LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

8.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **2,220,480 lekë**, nga B.Sh, A.V, A.P, E.L.

Menjëherë.

9-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Sistemim i shesheve të pallateve Nr.1, 2 dhe 3- Lagjia Nr.3, Bashkia Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxheti Bashkisë Kukës, është **3,650,920 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

9.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **3,650,920 lekë**, nga B.Sh, A.V, A.P, E.L.

Menjëherë.

10-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Rikonstruksion i qendrës sociale - Kukës*”, **shtesë kontrate, dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **2,870,880 lekë** si shpenzim i paligjshëm për vlerë të pa dokumentuar dhe të pa argumentuar, në kundërshtim me nenin 33 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

10.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **2,870,880 lekë**, nga B.Sh.

Menjëherë.

11-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëborat*” **shtesë kontrate, dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **1,485,120 lekë**, si shpenzim i paligjshëm për vlerë të pa dokumentuar dhe të paargumentuar, në kundërshtim me nenin 33 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

11.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **1,485,120 lekë**, nga B.Sh.

Menjëherë.

12-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës*”, **shtesë kontrate, dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **767,868 lekë**, si shpenzim i paligjshëm për një vlerë të pa dokumentuar dhe të pa argumentuar, në kundërshtim me nenin 33 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit).

12.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **767,868 lekë**, nga B.Sh.

Menjëherë.

13-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, Lagja Drinas, Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **2,206,498 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3, 56 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

13.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **2,206,498 lekë** nga B.Sh, A.V, A.P, E.L.

Menjëherë.

14-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Rehabilitimi i kanalit të uzinës, Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **3,280,014 lekë**, pasi kjo vlerë përbën shpenzim të paligjshëm shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

14.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **3,280,014 lekë**, nga B.Sh, A.V, E.L, G.C.

Menjëherë.

15-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Sistemimi dhe asfaltimi i unazës*

veriore të qytetit Kukës, Karburanti vjetër–Stacioni për Morinë” **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **19,084,914 lekë**, pasi kjo vlerë është shpenzim i paligjshëm i kryer nga Bashkia Kukës, si rezultat i vlerësimit të gabuar të ofertave pjesëmarrëse, në kundërshtim të plotë me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

15.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **19,084,914 lekë**, nga B.Sh, B.M, K.L, E.L.

Menjëherë.

16-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim i Qendrës së fshatit Orgjost”, **shtesë kontrate, dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **430,533 lekë**, pasi është shpenzim i paligjshëm ndaj shoqërisë “G...”shpk e cila ka të drejtë të realizojë vetëm 10% të punimeve, sipas aktmarrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, të nënshkruar midis operatorëve ekonomikë në prani të noterit, në kundërshtim të plotë me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

16.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **430,533 lekë**, nga B.Sh.

Menjëherë.

17-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “Blerje pjesë ndërrimi, goma, vajra lubrifikante” **dëmi ekonomik** i shkaktuar për buxhetin e Bashkisë Kukës në shumën **389,340 lekë me tvsh**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i kualifikimit të ofertës me vlerë me të lartë, në mospërputhje me nenin 52 “Hapja e ofertave” pikat (1); (6), nenin 53/3 “Shqyrtimi ofertave”, nenin 54 “Alternativat”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

17.1-Rekomandimi: Nga bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **389,340 lekë me tvsh**, nga L.D, A.D, F.T, në cilësinë anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Menjëherë.

-NË ZBATIMIN E KONTRATAVE TË NDËRTIMIT.

18-Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, lagja Drinas”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi se nuk janë aplikuar penalitetet për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **295,076 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 26 prot., datë 13.04.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe BOE “O...”SHPK & “O...”SHPK. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

18.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **295,076 lekë** nga operatorët ekonomikë “O...”SHPK e “O...”SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 26 prot., datë 13.04.2017 me objekt “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, lagja Drinas”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

19-Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i 7 kanaleve ujitëse”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **113,320 lekë pa tvsh** si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **359,689 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 26 prot., datë 18.05.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “D...”shpk. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

19.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **113,320 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “D...”SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr.

26 prot., datë 18.05.2016 me objekt “*Rikonstruksion i 7 kanaleve ujitëse*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

19.2-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **359,689 lekë** nga operatori ekonomik “D...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 26 prot., datë 18.05.2016 me objekt “*Rikonstruksion i 7 kanaleve ujitëse*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një penaltetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuara në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

20-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtimi i rrjetit të KUZ (segmenti Kukës - Uzinë)*”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara të pakryera në vlerë **237,430 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 31 prot., datë 25.05.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “D...”SHPK. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

20.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **237,430 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “D...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 31 prot., datë 25.05.2016 me objekt “*Ndërtimi i rrjetit të KUZ (segmenti Kukës - Uzinë)*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

21-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora (15 dhjetor 2015–31 mars 2016)*”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të administruara në dosje rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,775,000 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 113 prot., datë 18.12.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “G...”SHPK. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

21.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,775,000 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “G...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 113 prot., datë 18.12.2015 me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora (15 dhjetor 2015-31 mars 2016)*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

22-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të administruara në dosje rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **2,700,000 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr.36 prot, datë 17.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe BOE “R...”SHPK & “O...” SHPK. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

22.1-Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,700,000 lekë pa tvsh** nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R...”SHPK & “O...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 36 prot., datë 17.06.2016 me objekt “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

23-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora*”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të administruara në dosje rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por pakryera në fakt në vlerën **9,008,000 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 78 prot., datë 30.11.2016 dhe kontratën shtesë sipas aktit me nr. 23 prot., datë 03.04.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe BOE “O...” SHPK dhe “V...” SHPK. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

23.1-Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **9,008,000 lekë pa tvsh** nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “O...” SHPK dhe “V...” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 78 prot., datë 30.11.2016 dhe kontratën shtesë sipas aktit me nr. 23 prot me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë.

C-MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TE FONDEVE PUBLIKE.

1-Gjetje nga auditimi: Në vitin 2016 dhe 2017 nga Bashkia Kukës në 3 raste janë kryer pagesa në shumën 3,050,000 lekë nga fondi i planifikuar për programin “shërbimi social dhe administrimi i tyre” në bazë të VKB përkatëse për financim të trajtimit shëndetësor të familjarëve të 8 personave dhe 1 personi i janë financuar për 1 vit studimet universitare në SHBA në masën 200,000 lekë, kur sipas dispozitave ligjore të pushtetit vendor dhe financave të tij, financimi i rasteve të tilla nuk janë pjesë e funksionit për shërbimin social dhe e mbulimit të tyre me fonde, veprime në kundërshtim me ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” neni 24, me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 113, me Ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 110, pika 3, e VKM nr. 903, datë 21.12.2015 “Për përcaktimin e kriterëve të përfitimit e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”, me pasojë **efektin financiar negativ në shumën 3,050,000 lekë**.

1.1-Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të merren masa që në asnjë rast të mos bëhet propozim për Këshillin Bashkiak përballimi shpenzimeve të natyrës shëndetësore e bursave jashtë vendit.

Menjëherë.

2-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora*”, **vlera 2,480,000 lekë** e cila përbën vlerën totale të procedurës së zhvilluar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, si dhe 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përbën **efekt financiar negativ** për llogari të Buxhetit të Shtetit. Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, trajtuar hollësishtë më sipër. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

2.1-Rekomandimi; Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **2,480,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me përlllogaritjen e vlerës së fondit limit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për Bashkinë Kukës përbën efekt financiar negativ, si dhe raste të tilla, të mos përsëriten në të ardhmen.

Menjëherë.

3-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve*”, **shtesë kontrate vlera 819,812 lekë** e cila përbën vlerën totale të

procedurës së zhvilluar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përbën **efekt financiar negativ** për llogari të Buxhetit të Shtetit. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

3.1-Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **819,812 lekë**. Pasi është një vlerë e paargumentuar e pa dokumentuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendime përkatëse, vlerë e cila për Bashkinë Kukës përbën efekt financiar negativ, si dhe raste të tilla, të mos përsëriten në të ardhmen.

Menjëherë.

4-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i unazës veriore të qytetit Kukës, Karburanti vjetër–Stacioni për Morinë”, vlera **572,999 lekë** e cila përbën vlerën totale të procedurës së zhvilluar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përbën efekt financiar negativ për llogari të Buxhetit të Shtetit. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit).

4.1-Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **572,999 lekë**. Pasi është një vlerë e paargumentuar dhe pa dokumentuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendime përkatëse, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkinë Kukës, si dhe raste të tilla, të mos përsëriten në të ardhmen.

Menjëherë.

5-Gjetje nga auditimi: Në tenderi e zhvilluar me objekt “Blerje drurë dekorativ” me vlerë **1,263,600 lekë me tvsh** e cila përbën vlerën totale të kontratës së lidhur e likuiduar për marrje në dorëzim të drurëve dekorativ, të shkarkuara nga magazina përpara se të bëhen hyrje në magazinë, ndërsa fletë daljet nuk janë të shoqëruara me procesverbale për mbjellje të drurëve, mbjellja nuk është shoqëruar me skica dhe skema të gjatësisë së rrugëve ku janë kryer mbjelljet e drurëve, nuk është shoqëruar akt mbjellje të drurëve me kushtet në rast të mos mbirjes së drurëve, në kundërshtim me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Bashkisë. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit).

5.1-Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **1,263,600 lekë me tvsh**. Pasi është një vlerë e likuiduar paplotësuar specifikimet teknike. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendime përkatëse, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkinë Kukës.

Menjëherë.

6-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “Blerje mjetesh për nevojat e bashkisë” me vlerë **912,000 lekë me tvsh** e cila përbën vlerën totale të procedurës së zhvilluar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Bashkisë Kukës. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

6.1-Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **912,000 lekë me tvsh**. Pasi është një vlerë e paargumentuar e pa dokumentuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendime përkatëse, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkisë Kukës.

Menjëherë.

7-Gjetje nga auditimi: Për periudhën 2015 dhe 2016, nga mos zbatimi i nivelit të tarifave e taksave të miratuara u bë rivlerësimi dhe përlllogaritja e detyrimeve të lindura për pagesë nga subjektet e biznesit në vlerën **19,909,864 lekë**, për të cilët nuk ishte dërguar njoftim detyrimi për detyrimet e lindura, të cilësuar **të ardhura të munguara për buxheti** njësisë administrative bashkia Kukës (bashkëlidhur anekset nr. 1 e 2). (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 264-279 të Raportit të Auditimit).

7.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore për detyrimet e lindura si pasojë e rivlerësimit dhe përlllogaritjes të dërgojë “Njoftim detyrimin” për pagesë secilit subjekt për detyrimin e rivlerësuar në vlerën **19,909,864 lekë**, ndërsa një kopje të drejtohet në zyrën financës me qëllim kontabilizimin e detyrimit me analizë, veprim i pa realizuar deri në këtë moment.

Menjëherë.

8-Gjetje nga auditimi: Në tenderi e zhvilluar me objekt “*Blerje automjeti për nevojat e bashkisë Kukës*” me vlerë **3,000,000 lekë pa tvsh** e cila përbën vlerën totale të kontratës së lidhur dhe likuiduar pas marrjes në dorëzim të automjetit, pa plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të DST, për pasojë kontrata është likuiduar për mall jashtë kushteve teknike, në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, çka përbën efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të Bashkisë. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

8.1-Rekomandimi: Titullari i Autoritetit kontraktor të kërkoj në rrugë ligjore dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme për të analizuar vlerën prej **3,000,000 lekë pa tvsh**, si pagesë e likuiduar në mënyrë të **paligjshme me efekt financiar negativ** për buxhetin e bashkisë Kukës, në lidhje me realizimin e kontratës për blerjen e automjetit i bërë hyrje pa plotësuar specifikimet teknike të miratuara me DST, duke nxjerr përgjegjësinë ndaj komisionit të marrjes në dorëzim i përbërë nga B.T, R.H, I.E.

Menjëherë.

9-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt “*Rikonstruksion dhe asfaltim i rrugës Gomisteri Iseberi–Lagja Re Kukës*”, **efekti financiar negativ** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe të Bashkisë Kukës është **10,496,902 lekë**, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

9.1-Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **10,496,902 lekë**, Pasi është një vlerë e paargumentuar dhe pa dokumentuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendime përkatëse, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkinë Kukës, si dhe raste të tilla, të mos përsëriten në të ardhmen.

Menjëherë.

10-Gjetje nga auditimi: Në tenderi zhvilluar me objekt: “*Ndërtim i shtesës së shkollës Bajram Curri, Kukës*”, **efekti financiar negativ** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe të Bashkisë Kukës është **22,573,855 lekë**, shkaktuar si rezultat i procedurës së zhvilluar, në kundërshtim me nenin 33 të LPP. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

10.1-Rekomandimi: Titullari i AK të shqyrtojë vlerën **22,573,855 lekë**, pasi është një vlerë e paargumentuar dhe pa dokumentuar, si rezultat i procedurës së zhvilluar në kundërshtim me nenin 33 të LPP. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendime përkatëse, vlerë e cila përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e Bashkinë Kukës, si dhe raste të tilla, të mos përsëriten në të ardhmen.

Menjëherë.

D. MASA DISPLINORE:

D/1-Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germat “g” dhe “k” të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Kukës**, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit të Bashkisë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për **6** punonjësit e mëposhtëm:

a- “Largim nga shërbimi civil”, e parashikuar në nenin 58 gërma (ç) për nëpunësin civil, si më poshtë:

1- z.G.Ç. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, Prokurimeve dhe IT, në cilësinë konfirmuesi i ligjshmërisë së VKB.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për kryerjen e shpenzimeve në shumën 3,050,000 lekë nga fondi i planifikuar për programin “Shërbimi social dhe administrimi tyre” në bazë të VKB përkatëse për financim të trajtimit shëndetësor të familjarëve 8 personave dhe 1 personi i janë financuar për 1 vit studimet universitare në mospërputhje me ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen

vendore” neni 24, me nenin 53/3, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me UMF nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 113, me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 110, pika (3), me VKM nr.903, datë 21.12.2015 “Për përcaktimin e kriterëve të përfitimit e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fusha prioritare dhe studentët në nevojë”.

b-“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” e parashikuar në nenin 58 germa (c), për nëpunësit civil, si më poshtë:

2-z.A.V. me detyrë Drejtor i Buxhetit dhe Financës, në cilësinë nëpunësi zbatues dhe kryetar i KPVV.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për pagesë në shumën 715,000 lekë të zërit “punime të paparashikuara”, në masën 20% të vlerës së situacionit pjesor të projektit shkencor: “Kalaja e Pecës-Kukës, rivlerësimi i gërmimeve të viteve 1985/1989 dhe krijimi hartës së zonifikimit arkeologjik”, për të cilën nuk ka analiza dhe argumentim në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

-Për kryerjen e procedurës së parregullt të prokurimit me vlera të vogla, për blerjen e autoveturës së Policisë Bashkiake, si dhe shkeljet në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, lidhur me vlerësimin e ofertave konkurruese, në kundërshtim me nenin 53/3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4/26.

3-z.H.M. me detyrë specialist për prokurimet në Drejtorinë Juridike, në cilësinë anëtar i KPVV për vitin 2016 (NC në provë).

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për kryerjen e procedurës së parregullt të prokurimit me vlera të vogla, për blerjen e autoveturës së Policisë Bashkiake në kundërshtim me nenin 53/3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40 dhe ligjin nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26.

c) “Vërejtje” e parashikuar nga neni 58, shkronja (a) të ligjit nr.152/2013, për nëpunësit civil, si më poshtë:

4-z.M.H. me detyrë në cilësinë ish/Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave Vendore, (04.08.2015 deri 01.02.2016) dhe në cilësinë ish/Drejtor DTTV (01.02.2016 deri 25.05.2016).

5-z.V.G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave.

6-z.M.G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave në Terren.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për mos analizim nëpërmjet argumentimit dhe përlllogaritjes sa më afër realitetit të ardhurave vendore të krijuara nga aplikimi i nivelit të tarifës së pastrimit e largimit të mbeturina, të tarifës së gjelbërimit, të tarifës së ndriçimit dhe të taksës së pasurisë së paluajtshme (*banesa*, ndërtesa, objekte dhe tokën bujqësore), për subjektet familjare dhe subjekte të biznesit në juridiksion të njësisë administrative bashkia Kukës përfshirë njësitë administrative (ish/Komunat), me administrimin, dokumentimin dhe krijimin e regjistrave përkatës të taksapaguesve në mënyrë manuale, apo elektronike. Veprime në mospërputhje me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar; Udhëzimi plotësues buxhetit MF nr.03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit viti 2014”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, mbi të cilat Këshilli Bashkisë me vendime ka miratuar paketat fiskale në periudhat raportuese, duke përcaktuar

nivelin për çdo tarifë e taksë vendore që do të realizohen të miratuara sipas periudhave përkatëse me VKB nr. 77, datë 15.12.2014 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2015” konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti me shkresë nr. 1/13, datë 10.03.2015, VKB nr. 29, datë 26.02.2016 i cili ka miratuar vazhdimin e vendimit të mësipërm për zbatimin e të ardhurave të programuara nga zbatimi nivelit të taksa e tarifa vendore për njësi administrative bashkia Kukës përfshirë pas riorganizimit (*ish/Komunat*); VKB nr. 26, datë 08.01.2016 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2016” konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti me shkresë nr. 1/1, datë 12.01.2016 dhe VKB nr. 06, datë 16.01.2017 “Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2017” konfirmuar ligjshmëria nga Prefekti me shkresë nr. 1/9, datë 30.01.2017.

7-E.L., në cilësinë Anëtar i KVO.

8-A.P., në cilësinë Anëtar i KVO.

9-B.M., në cilësinë Kryetar i KVO.

10-K.L., në cilësinë Anëtar i KVO.

11-A.E., në cilësinë Anëtar i KVO.

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik të realizuara nga ky AK në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, 53/3 dhe neni 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (*Trajtuar hollësisht në faqen nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

D/2-Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa “e” dhe “ç” të nenit 11, Kreu IV dhe nenet 37 e 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe neni 9, të kontratës individuale të punës **i rekomandoj Kryetarit të Bashkisë Kukës**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **për 2 punonjësit e mëposhtëm:**

a-“Vërejtje” germa “a” e nenit 9, të kontratës individuale:

1-z.V.Ç. me detyrë drejtor Drejtorja e Planifikimit të Zhvillimit të Territorit për periudhën (01.02.2016 e në vazhdim).

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos ndjekjen e procedurave administrative e ligjore për përfundimin e fazës së miratimit të listave përfundimtare të transferimit të pronave për 13 (*ish/Komunat*) sot Njësitë Administrative përkatëse në pronësi të Bashkisë Kukës, veprime në mospërputhje me ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në Njësitë e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar dhe VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” neni 8 e 32. (*Trajtuar në faqe nr. 279-292 të Raporti të Auditimit*).

2-z.E.H. me detyrë drejtor Drejtorja e Pyjeve (*periudha 12.12.2016 - në vazhdim*).

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për mos ndjekjen e procedurave për verifikimin dhe përcaktimin e sipërfaqeve të rrugëve që shfrytëzojnë 30 subjektet e pajisura me lejë minerare nga karriera apo shesh depozitimet në rrugët nacionale në fondin pyjor e kullosor pronë e Bashkisë dhe lidhjen e kontratave të qiradhënies me taksimin e zënies së këtyre hapësirave. Po kështu për 8 shoqëritë koncensionare të HEC^{ve} që ushtrojnë aktivitetet në parcelat e fondit pyjor e kullosor pronë e Bashkisë, nuk është bërë identifikimi i sipërfaqeve që zënë ngrehinat dhe tubacionet, duke mos bërë lidhjen e kontratave të qiradhënies, apo taksimi zënies së hapësirës të këtyre subjekteve për sipërfaqet që shfrytëzojnë. Veprime në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me nenet 23, pika (7), 26, pika (10) të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, me VKM nr. 22, date 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kritereve të administrimit të pyllit komunal” pika (6), me UMB nr. 4, datë 22.4.2013 “Për përcaktimin e kritereve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor dhe kullosor publik”, me VKB viti 2016 dhe 2017 “Për taksat dhe Tarifat vendore” të cilat kanë sjellë pasojë të

ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë për periudhat 2016-2017. (Trajtuar në faqe nr. 292-299 të Raportit të Auditimit).

D/3-Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:

Për 5 ish punonjësit e mëposhtëm, do të propozohet masa disiplinore nga “ulje në detyrë” deri në “largim” për shkeljet të natyrës administrative të konstatuara në auditimin e kryer në Bashkinë dhe ish/Komunat Kukës, pavarësisht se nuk ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënie, ndjekje e zbatim.

1-z.L.D. me detyrë ish/Drejtor i Drejtorisë Ekonomik.

2-z.F.T. me detyrë ish/Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve.

3-z.B.B. me detyrë ish/Drejtor i Drejtorisë Juridik dhe Koordinim Zhvillimit.

4-z.I.K. me detyrë ish/Drejtor i Drejtorisë e Pyjeve periudha (01.06.2016-02.11. 2016).

5-z.P.D. me detyrë ish/Përgjegjës i Sektorit të të Ardhurave.

E- PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit) , pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

F-MASA ADMINISTRATIVE:

F/1-Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 4, 12, 19/7, 21, 23, 25, 28, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 46, 53, 56, 63, etj., të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. 9, 10, datë 24.02.2017 dhe nr. 29, 30, 33, datë 02.03.2017, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenin 15 germa (c, ç) dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i **rekomandojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik** të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), të **3** punonjësve për **1** procedurë prokurimi, si më poshtë:

1-z.I.E. me detyrë Specialist në drejtorinë Juridike, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit jashtë specifikimeve teknike. në kontratën e lidhur dhe e likuiduar.

2-z.B.T. me detyrë Specialist në Drejtorinë e burimeve njerëzore, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit.

3-z.R.H. me detyrë Specialist në Drejtorinë e Financës, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për marrje në dorëzim të mjetit, në kushte jashtë specifikimeve teknike DST,.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Për marrjen në dorëzim të automjetit, në kushtet pa plotësuar kërkesat e Specifikimeve teknike të miratuara në DST, në kontratën e lidhur me operatorin e shpallur fitues në tenderin me objekt “*Blerje automjeti për nevojat e bashkisë Kukës*”, duke sjellë pasojë likuidimin e

kontratë për mall jashtë kushteve teknike, në mospërputhje me kërkesat e parashikuara nga ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. *(Trajtuar hollësisht në faqen nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).*

4-B.Sh. me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë Titullar i AK

5-H.H. me detyrë ish/Kryetar i Bashkisë, në cilësinë ish/Titullar i AK

Për shkeljet e mëposhtme:

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik të realizuara nga ky AK në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, 33,38 dhe me neni 59, 60, 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

6-z.A.V. me detyrë Drejtori i drejtorisë Ekonomike, në cilësinë Kryetar i KVO.

7-z.B.M. me detyrë Sekretari i përgjithshëm, në cilësinë Kryetar i KVO .

8-z.K.L. në cilësinë Anëtar i KVO.

9-z.E.L. në cilësinë Anëtar i KVO.

10-z.B.B. në cilësinë Anëtar i KVO.

11-z.I.K. në cilësinë Anëtar i KVO.

12-z.H.M. në cilësinë Anëtar i KVO.

13-z.A.E. në cilësinë Anëtar i KVO.

14-z.A.P. në cilësinë Anëtar i KVO.

15-z.G.C. në cilësinë Anëtar i KVO.

Për shkeljet e mëposhtme:

Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik të realizuara nga ky AK në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 1, 53/3 dhe neni 68, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. *(Trajtuar hollësisht në faqen nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).*

F/2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Kukës t’i **kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë**, për mbikëqyrësin e punimeve si më poshtë:

z.Xh.N. në masën **50,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet:

a. “Rikonstruksioni 7 kanaleve ujitëse”, me sipërmarrës punimesh OE “D...”SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **113,320 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt si dhe prej mos marrjes së masave për aplikimin e penaliteteve në vlerën **359,689 lekë** për vonesa në përfundimin në afat të punimeve;

b. “Ndërtimi i rrjetit të KUZ (segmenti Kukës-Uzinë)”, me sipërmarrës të punimeve OE “D...” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **237,430 lekë pa tvsh**, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt;

G. Për Njësinë e Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Kukës.

Bazuar në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 15 shkronjat (i) dhe (f) dhe në nenin 25, i rekomandojmë Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kukës të shikojë, analizojë dhe auditojë shkeljet e ish-kryetarit të

Bashkisë H.H, duke evidentuar dhe përcaktuar përgjegjësitë administrative dhe penale. Mbi rezultatet e këtij auditimi të informohet KLSH^{në} menjëherë pas përfundimit.

Brenda muajit shkurt 2018

H. KALLËZIM PENAL:

-Bazuar në gjetjet dhe aktet e administruara në dosjen e auditimit, në referim të Ligjit nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale” i ndryshuar, neni 281 të ndryshuar; KLSH, ka dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës Titullarin e Autoritetit Kontraktor, si dhe të personave të tjerë, zyrtarë të këtij institucioni.

Shënim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal dhe Indicie Penale nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

K R Y E T A R I

Bujar LESKAJ